



## Mjetet e fondeve pensionale

Shoqëria pensionale është e detyruar që mjetet e fondit pensional t'i investojë në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore dhe me strategjinë e saj të investimeve. Në përputhje me rregullativën janë përkufizuar qëllimet dhe parimet e investimeve, llojet e instrumenteve në të cilat mund të investohen mjetet e fondeve pensionale, kushtet që duhet t'i përmbushin tregjet e rregulluara sekondare të kapitalit, ku tregtohet me mjetet e fondeve pensionale, cilësinë e instrumenteve në të cilat mund të investohen mjetet e fondeve pensionale, vendet ose grupet e vendeve në të cilat mund të investohen mjetet, kufizimet e investimeve brenda instrumenteve dhe emetuesve, investimet e ndaluara, tejkalimi i kufizimeve të investimeve, etj. Mjetet e fondeve pensionale përbëhen nga kontributet e paguara dhe kontributet e investimeve të anëtarëve dhe anëtarëve në pension, zvogëlimet për kompensimet e arkëtuara. Qëllimet e investimeve përcaktohen në dokumentet strategjike për investim - strategjia e investimeve dhe dokumenti për mënyrën e zbatimit të strategjisë së investimeve (taktika e investimeve). Arritja e rezultateve

E - MAPAS  
nr. 44

janar 2023



<http://MAPAS.MK>



<http://www.instagram.com/mapas.mk>



<http://www.linkedin.com/mapas.mk>



<http://www.facebook.com/MAPAS.MK>

"Ti je përgjegjës për edukimin tuaj financiar"  
Robert Kiyosaki

"Arsimi është parakusht për përparimin, në çdo shoqëri, në çdo familje".  
Kofi Annani



të investimeve të planeve pensione private dhe planeve të financimit kapital janë shtytësi kryesor i rritjes së mjeteve pensione. Strategjia e investimeve. Shoqëria pensionale që menaxhon fondin e detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional duhet të ketë dokument të strategjisë së investimeve. Strategjia e investimeve është dokument për investimin e mjeteve në lloje të ndryshme të instrumenteve financiare me qëllim të sigurimit të kontributit më të lartë në fondin pensional, duke i marrë parasysh qëllimet, tolerancën ndaj rrezikut, horizontin e investimeve në interes të anëtarëve dhe anëtarëve në pension të fondit pensional. Në veçanti, strategjia e investimeve duhet t'i përmbajë bazat për analizat që përfshijnë përcaktimin e kontributit të planifikuar të fondit pensional për një periudhë kohore që korrespondon me periudhën kohore në të cilën një anëtar me moshë mesatare të fondit pensional do të jetë anëtar në fond dhe duke marrë parasysh nivelin e shpenzimeve për jetesë

Në dokumentin e strategjisë së investimeve duhet të theksohet se si do të menaxhohen rreziqet që lidhen me arritjen e kontributit



të planifikuar dhe investimin strategjik të mjeteve, metodat për matjen e rrezikut të investimeve, proceset e menaxhimit të rreziqeve që do të zbatohen për të arritur kontributin e planifikuar dhe ndjekjen e mënyrës së realizimit të tij. Fondet pensionale janë investitorë afatgjatë dhe për këtë arsye strategjia e investimeve është dokument afatgjatë që i referohet periudhës prej të paktën shtatë vjet dhe duhet të revidohet të paktën një herë në tre vjet ose gjithnjë kur supozimet mbi të cilat bazohet kanë ndryshuar. Strategjia e investimeve duhet të shkruhet në mënyrë të qartë dhe të thjeshtë.

Faza e parë e procesit të investimeve përfshin kërkimin dhe analizimin e mjedisit makroekonomik, ekonomive, tregjeve të kapitalit në nivel global, rajonal dhe lokal të mbështetur nga analizat përkatëse për indikatorët kryesorë që janë të rëndësishëm për investimin.

Faza e dytë karakterizohet nga planifikimi, zhvillimi dhe hartimi i strategjisë së investimeve si bazë për investimin e mjeteve të fondeve pensione.



## Taktika e investimeve

Faza e tretë ose faza e zbatimit karakterizohet nga realizimi i strategjisë së investimeve,

korniza e përgjithshme e procedurave të menaxhimit të mjeteve të fondit pensional;

qëllimet investuese të fondit pensional;

Strategjia e investimeve duhet të përmbajë:

shpërndarjen strategjike të mjeteve të fondit pensional;

rreziqet e investimeve dhe proceset e menaxhimit të rreziqeve

ndjekjen, kontrollimin dhe vlerësimin e zbatimit të strategjisë së investimeve

përkatësisht planit të shpërndarjes së mjeteve të fondeve pensionale. Për këtë qëllim, të paktën një herë në vit, shoqëria pensionale për çdo fond pensional që e menaxhon, harton dokument për mënyrën e zbatimit të strategjisë së investimeve (taktika e investimeve). Shpërndarja taktike e mjeteve e paraqesin devijimin afatshkurtër (njëvjeçar) nga alokimi strategjik dhe përcaktohet në bazë të pritshmërive afatshkurtra dhe afatmesme për lëvizjen e tregjeve financiare dhe të klasave të veçanta të instrumenteve financiare. Ky dokument përfshin investimin strategjik (përzgjedhjen e instrumenteve dhe alokimin e mjeteve të fondeve pensionale) në çdo klasë të mjeteve, kufizimet interne të investimit dhe ekspozimin ndaj rreziqeve. Nëse vlerësohet nevoja, mund të bëhet ndryshimi / revizioni i këtij dokument në periudhë më të shkurtër se një vit.

Në hartimin e këtyre dokumenteve strategjike, si dhe në investimin e mjeteve të fondeve pensionale merret parasysh përmbushja e detyrës fiduciare, rregullat, procedurat dhe kufizimet interne, Kodi Etik dhe standardet e sjelljes profesionale dhe parimet e investimit të përcaktuara nga rregullativa, si dhe kufizimet interne të investimit.

## RISI

### Ditët e edukimit financiar

Nga 23 deri më 25 nëntor 2022 u mbajt edicioni i gjashtë i Ditëve të Edukimit Financiar, të organizuar nga institucionet rregullatore financiare, në bashkëpunim me sektorin financiar privat. Për Ditët e Edukimit Financiar, Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional MAPAS dhe shoqëritë pensionale u fokusuan në aktivitetet për ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe firmave për sigurimin pensional vullnetar ose të njohur si shtylla e tretë pensionale. Për këtë qëllim u organizuan bashkërisht edukime në më shumë firma në vend, ku menaxhmenti dhe punonjësit u njohën nga afër me mundësitë dhe përfitimet e kursimit afatgjatë në shtyllën pensionale vullnetare. Disa nga firmat në të cilat u organizuan prezantimet edukative ishin: Bella, Alfibi, Kozhuvçanka, Vitaminka, BTS ART Faktori, Tab Mak në Probishtip, XHAGATAJ - Shkup dhe Radiodifuzioni i Maqedonisë - Shkup. Nëpërmjet faqes së internetit të MAPAS-it, mundësohet inspektimi më i shpejtë dhe i vazhdueshëm i numrit të anëtarëve dhe i shumës së përgjithshme të mjeteve neto në fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale. Ndër funksionalitetet e reja të faqes së internetit është mundësia e parashtrimit digjital të deklaratave dhe kërkesave, si dhe mundësia e paraqitjes digjitale të parregullsive në MAPAS.

Qëllimi i këtyre aktiviteteve është të forcohet edukimi financiar, të inkurajohet inkluzioni financiar dhe të rritet ndërgjegjësimi dhe mbrojtja e anëtarëve tanë aktualë dhe të ardhshëm të fondeve pensionale.



## Komiteti për Stabilitet Financiar: Ruhet stabiliteti financiar

Sistemi financiar në vend është i qëndrueshëm, pavarësisht përshkallëzimit të vazhdueshëm të tensioneve gjeopolitike të krijuara nga pushtimi ushtarak i Rusisë ndaj Ukrainës, si dhe sfidat globale që lidhen me krizën energjetike dhe shkallët e larta të inflacionit. Megjithatë, në kushtet e rritjes së pasigurisë akoma më shumë theksohet nevojja për vlerësimin thelbësor të rreziqeve, menaxhimin përkatës të rreziqeve dhe ndërtimin e mëtejshëm të kapitalit për të siguruar kapacitetet më të madh të institucioneve financiare për thithjen e rreziqeve. Rregullatorët kompetentë i ndjekin gjendjet në mënyrë të koordinuar dhe janë të gatshëm të veprojnë shpejt, t'i përshtatin politikat në përputhje me zhvillimet dhe të mbajnë stabilitetin financiar, i cili është prioritet. Këto janë një pjesë e konstatimeve nga mbledhja e Komitetit për Stabilitet Financiar, ku u shqyrtuan lëvizjet më të reja në sektorin financiar.

Mbledhjen e kryesoi guvernatorja e Bankës Popullore, Anita Angellovska-Bezhoska, ndërsa morën pjesë edhe ministri i Financave, Fatmir Besimi, kryetarja e Komisionit për Letrat me Vlerë (KLV), Nora Aliti, kryetari i Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (MAPAS), Maksud Ali dhe kryetari i Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë për Mbikëqyrje të Sigurimit (AMS), Kërste Shajnoski



Kryetari i Agjencisë për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional - MAPAS, Maksud Ali, theksoi se gjendjet globale rrjedhëse si pandemia, kriza energjetike, konflikti ushtarak, rritja e shkallës së inflacionit dhe lëvizjet e tregjeve financiare njihen si nga MAPAS-i, si rregullator dhe mbikëqyrës, ashtu edhe nga shoqëritë pensionale si bartëse të procesit të investimeve, përkatësisht menaxhimit të mjeteve të fondeve pensionale.

### Keni pyetje dhe ankesa?

Lajmërohuni në MAPAS ose shkruani mesazh në [contact@mapas.mk](mailto:contact@mapas.mk)



AGJENCIA E SUPERVIZIONIT TË SIGURIMIT PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL  
(MAPAS)

Stiv Naumov 100, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut,  
tel: (02) 3224 229

<https://mapas.mk>